

VENDIM
Nr.110, datë 4.3.1997

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.24, DATË 20.1.1997 “PËR PËRDORIM FONDESH BUXHETORE PËR BLERJE
BANESASH PËR ISH-TË PËRNDJEKURIT POLITIKË”

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.24, datë 20.1.1997 “Për përdorim fondesh buxhetore për blerje banesash për ish-të përndjekurit politikë”, shtohet paragrafi:

1. Brenda shumës totale prej 49.9 milionë lekësh, fondi prej 38 milionë lekë të përdoret për strehimin e ish-të përndjekurve politikë të rrethit të Tiranës.

2. Përdorimi i shumës prej 38 milionë lekësh do të bëhet nëpërmjet blerjeve nga tregu i lirë i banesave nga ana e vetë qytetarëve, sipas listave nominale të shoqëruara me strukturat e apartamenteve tip përkatës të paraqitura nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.

3. Enti Kombëtar i Banesave, sipas listave dhe strukturave të apartamenteve tip që i shoqërojnë këto lista për secilin qytetar në bazë të normave të strehimit vë në dispozicion të çdo qytetari shumat limit përkatëse si më poshtë:

a) Për apartamentet (1+1) shumën 0.98 milionë lekë;

b) Për apartamentet (2+1) shumën 12.53 milionë lekë.

4. Enti Kombëtar i Banesave kryen veprimet financiare me shitësit e apartamenteve vetëm pas paraqitjes dhe verifikimit të dokumenteve ligjore që vërtetojnë kryerjen e aktit të blerjes së banesave nga personat përfitues.

5. Në rast se brenda afatit prej dy muajve të vënies në dispozicion të fondeve të përcaktuara si më sipër në pikën 3, qytetarët nuk kanë kryer veprimin e blerjes së banesave, atyre u humbet e drejta e trajtimit si familje të pastreha.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Enti Kombëtar i Banesave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi